



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 02-060/03-54216 dt. 20.10.2022

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glogocit), nenit 3 pika 3.7 si dhe nenit 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **27.10.2022** (E Enjte) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 27.09.2022.
2. Raporti Financiar Janar-Shtator 2022.
3. Propozim vendim për formimin e Komisionit për strukturën organizative dhe funksionale të fshatrave dhe lagjeve urbane me qëllim të organizimit dhe zgjedhjeve.
4. Raport nga Drejtoria e Infrastrukturës Lokale për realizimin e Projekteve gjatë këtij viti dhe planifikimi për tre muajt e ardhshëm.
5. Propozim vendim për shpalljen e Prof. Dr. Rexhep Meidani “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.
6. Propozim vendim për shpalljen e Prof. Dr. Alfred Moisiu “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.
7. Propozim vendim për shpalljen e Prof. Dr. Bamir Topi “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.
8. Propozim vendim për shpalljen e SH.T.Z Prof. Dr. Bajram Begaj “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.
9. Propozim vendim për shpalljen e SH.T.Z. Edi Rama “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.
10. Propozim vendim për shpalljen znj. Ana Roch “Qytetare Nderi” e Komunës së Drenasit.
11. Të ndryshme.

Drenas, 20.10.2022



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLOBOC			
GLOBOC MUNICIPALITY			
Data: 20.10		20 22	
Nj. Ord.	Kumër	Sh. ka	Vlera
02-060/03-54226			



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Zyra e Kuvendit



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 20.10.2022, si vijon:

-Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e K. P. F-ca, për rendin e ditës, me një pikë shtesë me nr.9,e poshtëshënuar.

Pastaj i pyeti të pranishmit nëse ka dikush debat rreth pikave të rendit të ditës mundet me marr fjalën:

- Fjalën e mori z. Hamit Hagjiu ku Rekomandoi të propozohet për ta shpallur qytetar nderi të Komunës së Drenasit **Dr. Sali Berishën.**

- Fjalën për rekomandim e mori edhe Arbër Halilaj ku rekomandoi:

1. Të kemi një rregullore mbi dekoratat dhe titujt e nderit.
2. Të krijohet Komisioni për ndarjen e titujve dhe dekoratave, të përberë nga anëtarët e Kuvendit dhe shoqëria civile, që nëpërmjet rregullores për vlerësimin e personave me merita dhe kontribut të Veçantë për Komunën tonë, do të qonte në vend idenë e shpërblimit të tyre me tituj nderi.

Pikë shtesë për rendin e ditës propozoi Florentina Elezi Veliu e poshtëshënuar me nr. 10.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi hedhi në votim rendin e ditës me dy pika shtesë.

- Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt. 21.09.2022.

- Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00

2. Raporti Financiar Janar-Shtator 2022.

- Rekomandohet për Kuvend

3. Propozim vendim për shpalljen e Prof. Dr. Rexhep Meidani “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.

- Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00

4. Propozim vendim për shpalljen e Prof. Dr. Alfred Moisiu “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.

5. Propozim vendim për shpalljen e Prof. Dr. Bamir Topi “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit

6. Propozim vendim për shpalljen e SH.T.Z Prof. Dr. Bajram Begaj “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.

7. Propozim vendim për shpalljen e SH.T.Z. Edi Rama “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.

8. Propozim vendim për shpalljen znj. Ana Roch “Qytetare Nderi” e Komunës së Drenasit.

- Votuan si pako 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00

9. Propozim vendim për formimin e Komisionit për strukturën organizative dhe funksionale të fshatrave dhe lagjeve urbane me qëllim të organizimit dhe zgjedhjeve.
- **Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
10. Raport nga Drejtoria e Infrastrukturës Lokale për realizimin e Projekteve xhat këtij viti dhe arsyen e ngecjes së projekteve.
- **Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
11. Të ndryshme.

Pasi nuk pati diskutime mbledhja përfundoi në ora 11: 00.





Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 02-060-54319 dt. 20 10 2022

PROCESVERBALI

I mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **27.09.2022**

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 31 anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KK i mbajtur më dt. 31. 08.2022.
2. Raporti i degjimeve publike për listen e projekteve kapitale për buxhetin e vitit 2023 dhe projeksioneve për vitet 2024-2025.
3. Propozim Vendim i Buxhetit të Komunës së Drenasit për vitin 2023-2025.
4. Propozim vendim për formimin e Komisionit të ankesave i cili do të shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.
5. Propozim vendim për formimin e komisionit komunal të aksionereve për NPL Stacioni i Autobusëve SH.A – Glllogoc.
6. Propozim vendim- Me këtë propozim vendim kërkohet që automjetet zyrtare të QKMF “Dr. Hafir Shala” Drenas, si dhe automjetet e Qendrës për punë sociale- Drenas, të kalojnë në pronësi të Komunës së Drenasit.
7. Raporti i progresit për Implementimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2021.
8. Raport nga menagjerët e dy Kompanive KRU-„Ujësjells” dhe KRM- „Pastrimi” njesia Drenas
9. Të ndryshme.

Të martën me dt.27.09.2022 është mbajtur mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit, ku për diskutim ishin 9 pika për rend dite.

Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, ndërsa merrnin pjesë, kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Arben Shala, drejtor të drejtorive komunale, anëtarët e Kuvendit, zyra e informimit, menagjeri e Kompanisë KRU-„Ujësjells” Ismet Baliu, dhe Kastriot Berisha menagjer KRM- „Pastrimi” njesia Drenas.

Më poshtë ju elaborojmë pikat që janë diskutuar e miratuar me shumicë votash në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës:

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hadari- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit njoftoi me rendin e ditës anëtarët e Kuvendit Komunal.

Egzona Tërdevci, sa i përket materialit ne e kemi marrë ftesën shumë vonë e kemi pranuar të mërkurën, po ashtu kemi raport nga menaxherët e dy Kompanive KRU-„Ujësjells”, dhe KRM- „Pastrimi” njesia Drenas na nuk kemi pranuar kurrfarë raporti, cila është ideja ne vetëm me i degju kur nuk kemi një raport paraprak më herët.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, mbledhja e rregullt u vendos me u thirr një ditë me herët për me u mbaj mbledhja dhe ky vendim u mor në komitetin për Politikë e Financa, dhe propozim vendimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2023-2025 ka shtesa të emërimit të projektit, ministria ka kërkuar një specifikim më të saktë për projektete.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës: prezent gjatë votimit ishin 31 anëtar, **(Për)** votuan 31 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes të Kuvendit Komunal të dt. 24.06.2022.**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 31 anëtar, **(Për)** votuan 28 anëtar, kundër 3, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Raporti i degjimeve publike për listen e projekteve kapitale për buxhetin e vitit 2023 dhe projeksioneve për vitet 2024-2025.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, Të nderuar anëtar të Kuvendit të Komunës, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës e keni para vetës edhe Raportin e degjimeve publike për listën e projekteve kapitale për buxhetin e vitit 2023 dhe projeksionet për vitet 2024-2025 të mbajtura gjatë muajit Shtator.

Në bazë të Ligjit mbi financat publike, degjimet buxhetore për listën e investimeve kapitale i kemi mbajtur me grupe të interesit qytetarë. Fillimisht kemi mbajtur degjimin publik me shoqëri civile, OJQ dhe biznese, pastaj kemi mbajtur edhe degjimin e përgjithshëm gjinor për tu zhvendosur në bashkësi lokale, ku gjithsej janë mbajtur 8 degjime buxhetore.

Këto degjime buxhetore janë thirru nga Kuvendit, përkatësisht nga Komiteti për Politikë e Financa, por një pjesë e vogël e anëtarëve të Kuvendit kanë shprehur gatishmërinë për të marr pjesë në këto takime me qytetarë, për të diskutuar projektet kapitale që janë me interesin e përgjithshëm të qytetarëve.

Ndonëse pjesëmarrja nuk ka qenë shumë e kënaqshme, megjithatë obligim ligjor e kemi që këtë Raport me e diskutu në mbledhje, prandaj fjala është për juve nëse dikush dëshiron të marr fjalën, nëse jo, atëherë ky dokument vetëm diskutohet, por nuk miratohet.

Azmine Bujupi-Gjoka, sa i përket raportit të dëgjimeve publike për listën e projekteve kapitale për buxhetin e vitit 2023 dhe projeksioneve për vitin 2024-2025 me keqardhje po e them por dëgjime publike me qytetar nuk ka pas, ato u zhvilluan vetëm me stafin e shkollave aty ku u mbajtën dëgjimet me drejtor të drejtorive dhe zyrtar komunal, arsye a se qytetaret prezantuan fare pak në këto dëgjime publike ishte sepse kërkesat e tyre ishin të njëjta qysh në mandatin e parë të kësaj qeverisje pra para katër viteve ishin këto kërkesa që po i ceki: furnizimi i qytetareve me ujë të pijes, kërkesë kjo që jo vetëm me qytetar por edhe e asamblistëve ne seancë që deri me tani nuk është realizuar, rregullimi i rrjetit të kanalizimit, rregullimi i ndriçimit publik, rregullimi i rrugëve për persona me aftësi të kufizuara, asfaltimi i rrugëve, transporti i fëmijëve në shkollë, legalizimi i banesave në Poklek të Ri që janë lënë pas që nga viti 2008, nga shoqata e grave ishte një kërkesë për realizimin e projektit për fuqizimin ekonomik të gruas si dhe një fond emergjent që është kerkuar nga këto gra për trajtimin e rasteve të viktimave të dhunës në familje, pra këto ishin kërkesat elementare të qytetareve të Drenasit.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladroci, sa i përket ujit të pijes i kemi sot prezent menaxherët e dy Kompanive KRU-„Ujësjellësi”, dhe KRM- „Pastrimi” i kemi sjellë këtu për arsye që me i informua qytetaret se komuna e ka kry do obligim të vetin që e ka pas këtë drejtim dhe me e shiku se kush është përgjegjës qoftë për ujë qoftë për mbeturina. Në KPF u rekomandua që me sjellë raporte 6 mujore ose raporte 3 mujore.

Egzona Tërdevci, edhe unë kam marrë pjesë në dëgjime buxhetore dhe e kam shiku se pjesëmarrja ishte shumë e vogël, por unë e kam një shqetësim tjetër në raport me qasjen e komunës në raport me qytetart, une kam marrë pjese në dëgjime më zonën lokale Baicë-Tërdevc, me shumë të drejt një banor i Tërdevcit ka kërkuar trotuar për fëmijët që i dërgojnë në shkollë, ndërsa nënkryetari iu ka përgjig se a kane prind ata fëmijë se nuk i dërgojnë në shkollë, nuk është detyrë e institucionit me i pyet prind se a ka kush me i dergu në shkollë, pas kësaj nesi institucion e kemi për obligim ne ia rregullu rrugën apo çka ata kërkojnë në kuadër të mundësive buxhetore që i kemi, kjo nuk është dashtë me u përsërit më.

Nënkryetari i Komunës Arben Shala, ajo çka u tha atë ditë është vetëm maja e zverkut, sa për informacion qytetaret e saj pjesë as nuk kanë lejuar hapjen e gypave kullues e lere më për trotuar, dhe kjo çka ju qaseni nuk qëndron.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e trete të rendit të ditës: **3. Propozim Vendim i Buxhetit të Komunës së Drenasit për vitin 2023-2025.**

Arbër Halilaj, kjo pikë është shumë e rëndësishme për rendin e ditës, një sugjerim apo vërejtje që e kemi dhenë në mbledhjen e KPF-ca, si duket ato nuk po merren parasysh, është fjala të projektet apo të kodi 451 aty ceket vetëm asfaltimi i rrugës në fshatin Gradicë, apo Dobroshefc, fjala është që me e cek më ne detaje se cila rrugë shtrohet me saktë, gjatësia e saj, me e specifikua më saktë projektet ashtu siç e kemi kërkuar edhe në mbledhjen e KPF-së. Me vjen mirë që të drejtorja për infrastrukture janë projekte që kanë të bëjnë ehe me mjedisin me grumbullimin e ujërave të zeza mirëpo vërejtja kryesore është kjo sepse asfaltimi i rrugës në një fshat pa u cek me saktësisht si, është e pa pranueshme.

Beqir Kiqina, sa i përket propozimit të buxhetit të komunës për vitin e ardhshëm po e shoh që është në përputhje me kornizën dhe qarkoren buxhetore 2023-2025. Buxheti i komunës për vitin 2023 parasheh një vlerë prej 18.156.892.00 euro kjo shumë uroj që t'i mbuloj kërkesat e komunës tonë, por kërkoj nga drejtoritë përkatëse që ky buxhet të implementimet edhe të shfrytëzohet në mënyre sa ma racionale, kërkoj edhe nga Drejtoria e Urbanizimit që projektet që janë sa më parë të implementimeve edhe për këtë vit.

Egzona Tërdevci, unë i kam disa pyetje dhe kërkesa lidhur me buxhetin si kërkesë primare për buxhetin e vitit 2023 ende mbetet furnizimi i ujit te pijes, për vitin 2023 për ndërtim të kapacitetit të ujësjellësit vetëm në një kod janë paraparë 270 mijë euro sa ka me qenë mbuloshmeria e furnizimit me ujë të pijes deri në fund të vitit 2023 për qytetaret e Drenasit sa përqind të projekteve kapitale të parashikuara për vitin 2023 tashme janë të filluara për disa vetëm kam informacione se janë projekte aktuale, tek buxheti nuk ka kode buxhetore, të gjitha kodet buxhetore janë paraqitur vetëm në një kod buxhetor unë mendoj se secili projekt duhet të ketë kod të veçantë buxhetor, po ashtu tek lista e projekteve kapitale është një projekt bashkëfinancim me donatoret e jashtëm dhe nuk ka asnjë evidencë për donacionet e jashtme të planifikuara kërkoj një sqarim, si është mëndu të jetësohet ky projekt vlere e mëhershme ka qenë 50 mijë ndërsa tani që janë bashkuar janë 55 mijë, po ashtu të Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport janë paraparë tek linja buxhetore e fundit ndërtim të shtëpisë se kulturës, muze, bibliotekë, teatër, galeri a behet fjale për një qendër multifunksionale apo kane me u ndertu si objekte të ndara? Një nga premtimet në fushën e drejtorisë se Kulturës Rinise dhe Sportit ka qene edhe ndërtimi i poligonit sportiv në Drenas për vitin 2023 sa shikova nuk ka mjete të ndara a mundem me e ditë se kur do të realizohet kjo kërkesë? Tek shëndetësia janë paraparë 70 mijë euro për dy vetura te ndihmës se shpejtë, sipas informatave që i kemi ne çmimet e veturave te ndihmës se shpejte janë pak më të larta se kaq, a jeni të sigurt që mjetet e ndara mjaftojnë për furnizim për dy vetura. Kam shqetësim lidhur me raportimin për mallra dhe shërbime i keni raportuar vetëm ne tërësi por jo me kode buxhetore, por ashtu me shqetësime se ka shumë pak parkingje në Komunën e Drenasit janë paraparë vetëm 5 mijë euro për rregullim e trotuareve dhe mirëmbajtjen e trotuareve dhe parkingjeve sa do t'i evitoj kjo telashet me parking sidomos gjate kohës se verës dhe dimrit kur e dina se fluksi i mërgimtareve është i madh.

Hamit Haxhiu, materiali ka mangësi te mëdha-ja, në Drejtorinë e infrastrukturës nuk ka kurrfarë specifikimi të rrugës, nuk është segmenti i rrugës, nuk është emri i rrugës, nuk e di se si gjithë këto mjete për infrastrukturë të rrugës për asfaltim të rrugës kur kryetari e ceki me herët se nuk ka rrugë të pa asfaltuar, pse gjithë këto investime me i bërë në infrastrukturë?

Drejtori i Financave Shyqiri Bublaku, sa i përket buxhetit të komunës siç e ceki edhe parafolësi Beqir Kiqina ne ju kemi përmbajte qarkores së dytë buxhetore ku i kemi ruajt kufijtë buxhetor të cilat na përcakton për të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimeve për buxhetin e komunës së Drenasit për vitin 2023 dhe parashikimet për vitet 2024-2025. Sa i përket bashkimit të projekteve i kemi bërë me kërkesë të qytetareve dhe ne koordinim me Ministrinë e Financave dhe punës dhe transferove i kemi bërë fuzionimin e këtyre projekteve. Të bashkëfinancimet nuk mundemi me e ditë se me kë kemi me bashkë financua deri të hyjmë në vitin 2023 dhe te na ofrohet mjete prej OJQ-ve apo nga ndonjë organizate e jashtme që dëshiron me na ndrimu ne realizimin e projekteve. Tek fushat sportive janë cek të lista e projekteve kapitale ku kanë me u vendos ne vitin 2023.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, e kam cek se po thuajse nuk ka mbet rruge publike pa u shtru, qeveria na ke kane kërkuar me i specifikua me detaje projektet dhe e kemi bere

edhe përcaktimin e saktë të çdo gjeje, ne shtëpinë e kulturës po mundohemi me e bere në Drenas dhe besoj se do ta bëjmë. Sa i përket parkingut shumë shpejt do të fillojmë me e ndërtua parkingun afër rrugës trenit besoj se këtë vit do të përfundoj. Ai 5000 € është për bashkëfinancim me donator ose me grande që mund t'i fitojmë e kemi një kod të caktuar për një projekt. Sa i përket ujësjellësit, kemi bere shume investime sa i përket ujësjellësit mirëpo përgjegjësit e ujësjellësit e kanë pas për obligim me ardh me marr pjesë ne debate publike kur formohet buxheti me i propozu kërkesat dhe nevojat e tyre, sepse na investojmë kapacitet për me ia dorëzua kompanisë te ujësjellësit të cilën as nuk e menaxhojmë, as nuk e drejtojmë dhe as inkasojmë prej asaj që investojmë, ndërsa me ligj e ka ujësjellësi për t'i bërë këto investime vet.

Mërgim Pirraku, para vetëm e kemi planifikimin që e keni bërë dhe unë kam besim shumë tek drejtori Shyqiri Bubaku, megjithatë kam disa vërejtje, me herët keni bërë disa diskriminime për disa fshatra edhe për disa lagje, por disa fshatra që kanë pas asamblistët ose kanë pas njerëz këtu ne komune kane realizuar me dhjetra projekte ndërsa ne disa fshatra jo, Fushtica e Lartë dhe Sankoci janë dy fshatra qe i keni lan shumë pas dore, pres që me i realizua disa projekte për këto fshatra dhe me i barazu me disa fshatra që janë shume afër këtyre, e keni ndarë buxhetin ne mënyrë te barabartë, pa barazinë që e keni krijuar me herët u dasht me e plotësua dhe me e kriju një barazi të re.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, në fshatin Sankoc dhe Fushticë kemi investuar shumë, qofte në kanalizim të ujërave të zeza qoftë rrugë qoftë edhe shkollën e re, ne gjitha pronat e Sankocit i kemi fut ne Hartë zonale për investime kapitale.

Mehedin Salihu, pajtohem me Mërgimin se shumë fshatra janë lënë pas dore këtu përfaqësohet edhe fshati Shtuticë, me ndriçim me infrastrukturë, me kanalizim të ujërave të zeza.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, kemi investu aq sa kemi pas mundësi me investu dhe sa kemi pas kapacitet me investu.

Hamit Haxhiu, kjo është një pikë shumë e rëndësishme, unë e kam shikuar, asfaltimi i rrugës Llapushnik-Berishë unë jam për kësaj por pse me i shpenzu na 330 mije euro për këtë qeshtje kur ka alternativa tjera, e ceki kryetari që ne qendër nuk është punu asgjë, nga 37 premtime që i ka bere kryetari janë të realizuara vetëm 18 %. Vota ime është kundër buxhetit.

Hamit Haxhiu, asfaltimi i rrugës Poklek i vjetër, Poklek i Ri, Vasilevë për tri vjet janë 540 mijë euro, unë nuk e di as sa është segmenti e as a cila rrugë ka me u shtru, as nuk ka ndriçim, sa i përket Drejtorisë se Arsimit pse profesorët apo mësuesit me shku me përmbaues me prit nga dy vjet per rroga, kërkoj me e nda nje kod buxhetor të veçantë për mësimdhënësit.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, sa i përket ujit të pijes është premtim i cili nuk është varur nga unë, sa i përket mësimdhënësve edhe ne kemi bërë të njëjtën kërkesë dhe nuk kane ndarë buxhet për atë çështje.

Pas diskutimeve që u dhanë kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **(Për)** votuan 18 anëtar, kundër 11, abstenim 1. U miratua **Propozim Vendim i Buxhetit të Komunës së Drenasit për vitin 2023-2025.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e kater të rendit të ditës. **4. Propozim vendim për formimin e Komisionit të ankesave i cili do të shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, theksoj se komisioni formohet prej 5 anëtareve për formimin e komisionit të ankesave i cili do të shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci për anëtar të komisionit nga ekzekutivi propozoj:

1. Armend Hajdini
2. Besart Bajrami
- nga OJQ 3. Kaltrina Gashi

Bekim Lestrani, nga grupi i PDK-së për anëtar të komisionit propozojmë: Zeqir Hasi.
Azemine Bujupi- Gjoka, nga grupi DD për anëtar të komisionit propozojmë: Hamit Haxhiu.

Pas propozimeve që u dhanë kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar, **(Për)** votuan 28 anëtar, kundër 00, abstenim 0. U miratua kjo pike e rendit të ditës me këtë përbërje të komisionit:

1. Armend Hajdini - anëtar nga ekzekutivi
2. Besart Bajrami - anëtar nga ekzekutivi
3. Zeqir Hasi - anëtar nga kuvendi
4. Hamit Haxhiu - anëtar nga kuvendi
5. Kaltrina Gashi - anëtare nga OJQ.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim vendim për formimin e komisionit komunal të aksionereve për NPL Stacioni i Autobusëve SH.A – Gillogoc.**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci për anëtar të komisionit nga ekzekutivi propozoj:

1. Rinore Zymberi- anëtare nga ekzekutivi.

Bekim Lestrani, nga grupi i PDK-së për anëtar të komisionit propozojmë: Arigon Sinani.
Azemine Bujupi- Gjoka, nga grupi DD për anëtar të komisionit propozojmë: Marigona Bazaj.

Pas propozimeve që u dhanë kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar, **(Për)** votuan 28 anëtar, kundër 00, abstenim 0. U miratua kjo pike e rendit të ditës me këtë përbërje të komisionit:

1. Rinore Zymberi- anëtare nga ekzekutivi.
2. Arigon Sinani- anëtar nga kuvendi
3. Marigona Bazaj- anëtar nga kuvendi.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Propozim vendim- Me këtë propozim vendim kërkohet që automjetet zyrtare të QKMF “Dr. Hafir Shala” Drenas, si dhe automjetet e Qendrës për punë sociale- Drenas, të kalojnë në pronësi të Komunës së Drenasit.**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar, (Për) votuan 28 anëtar, kundër 0, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Raporti i progresit për Implementimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2021.**

Egzona Tërdevci, tek rekomandimet që janë zbatuar pjesërisht sa janë gjasat që me u perfundu për me u zbatu në tërësi sikur ato te tjerat?

Drejtori i Financave Shyqiri Bublaku, rekomandimet që janë zbatuar pjesërisht, pagesat janë bere përmes vendimeve gjyqësore, është lami të cilën nuk mundemi me e zbatu në tersi sepse po vijnë kërkesa nga sektori i arsimit dhe ajo nuk varet drejtpërdrejt nga ne , sa i përket zbatimit të rekomandimet të dytë një pjese e qytetareve tanë jetojnë jashtë dhe brenda vitit dhe brenda vitit nëse nuk e merr një dokument personal të tij, dhe ai nuk njihet në faturën tatimore, tjetër një pjesë e qytetareve e kane pronën ende ne emër të gjyshërve, per këto arsye janë pjesërisht, të zbatuara janë 7, 4 janë pjesërisht dhe 1 nuk ka periudhë krahasuese.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Raport nga menagjerët e dy Kompanive KRU-„Ujësjellsi”, dhe KRM-„Pastrimi” njesia Drenas.**

Raport nga menaxheri i KRU-„Ujësjellsi”- Ismet Baliu, ju njoftoi me pikat kryesore me çështjen e furnizimit me ujë të pijes, menaxhimi i ndërmarrjeve publike regjionale, aksionari kryesor për kompanitë regjionale është Qeveria e Kosovës përkatësisht Ministria e Zhvillimit Ekonomik, agjencinë rregullative i ujërave i cili rregullon anën ligjore dhe rregullative për të gjithë ujësjellsit i formuar nga Parlamenti i Kosovës, bordi i kompanive regjionale, krye shefat, menaxheret e departamenteve dhe menaxheret e njësive. Menaxhimi i ujësjellsit të Drenasit është pjesë e kompanisë regjionale “Prishtina” i cili ka gjithsej 26 punëtor. Burimi kryesor i furnizimit me ujë të pijes për qytetaret e Komunës së Drenasit është pellgu i lumit “Iber” përkatësisht Liqeni i Ujemanit ku përmes kanalit të Iberlepencit deri në fshatin Bivolak dhe procesi i filtrimit i klorifikimit behet përmes rezervarëve në Qikatovë të vjetër ku në fabrike për përpunim te ujit fillon përpunimi i ujit. Kapaciteti i prodhimit për ujë të pijes është kapaciteti max është prej 150 deri në 180 L në sekond ose mbi 600 m³ në orë. Me këto kapacitete kemi mundësi t’i furnizojmë deri në 60 mijë banor. Shpërndarja e ujit të pijes bëhet në dy zona ne zonat urbane të qytetit dhe zonat rurale. Aktualisht furnizohen rreth 50 % e banoreve të Komunës se Drenasit. Furnizimi nga fabrika përmes rrjetit është me ramje të lirë.

Zonat rurale :Fshatrat që kanë furnizim me ujë janë Shtrubullovë,Poklek ,Gllobar,Tërstenik 1,Komoran 1-2-3,cikatove e vjeter,Dobroshevc,Pjeserisht Gllanasella pothuajse 90%,Zabeli I Lartë me mbulueshmëri 130 km rrjet kryesorë të materialeve te ndryshme te gypave si dhe me rrjet te ri qe zavendeson gypat ekzistues te azbest cementit,

Zonat rurale qe janë ne procedure te finalizimit te rrjeteve eshte :likoshani dobroshevc i shtutica tersteniku korretica e ulte zabeli I ulte,verbovc,godanc polluzhe,baic korretice e larte edhe sankoci veq eshte I furnizuar,gjatesia e rrjetit ne kto zona eshte mbi 100 km rrjet pa kyqje sekondare.

Janë edhe fshatra që nuk janë të kyqura në rrjet të ujësjellsit dhe nuk menaxhohen nga ujesjellesi eshte fjala per krajkoven qe ka nje rrjet te ujësjellsit por nuk menaxhohet prej ujesjellesi, Damaneku,

Lapushniku, Vasileva, vuqaku, nekovci, gradica, poterku, arrllat, negrovc, gjorgjic, kizhnarek dhe fushtice. Kizhnareka ka rrjet të ujësjellësit por nuk kalon për arsye se nuk kanë gatishmëri të kaloj ne menaxhim rrjeti i tyre tek ujësjellësi i qytetit.

Furnizimi me ujë në zonat që i mbulon furnizimi me ujë i qytetit gjatë këtij viti kemi pasur një furnizim relativisht të mirë me përjashtim gjatë muajit korrik dhe gjysmën e muajit gusht kemi pasur reduktime dy orë në qendrën e qytetit me qellim të furnizimit të mjaftueshëm të disa zonave të larta për shkak të këtyre zonave ka pasur ulje të presionit të ujit, me qellim të furnizimit të këtyre zonave

Kontrollimi i kualitetit të ujit në zonen e shërbimit behet nga departamenti i kualitetit të ujit të pijes në nivel të kompanisë regjionale prishtina si dhe nga instituti kombëtar i shëndetësisë publike të kosoves ku për kto analiza që behen leshohen edhe raportet të kontrollit të kualitetit, të klorit rezidual në rrjeta dhe shpërndarjes

Fakturimi, tarifat për fakturim i cakton autoriteti rregullativ për ujë dhe kanalizime në nivel të republikës së kosoves.

Tarifat me vendim të autoritetit rregullativ për amvisi tarifa fikse është për vitin 2022-1 euro dhe tarifa volumetrike për m³ të ujit është 0.44 euro për ujërat e zeza (Kanalizim) është 0.06 euro për m³

Institucionet dhe bizneset kanë tarife fikse prej 2 euro dhe tarifa volumetrike është 0.67 cent m³ për ujërat e zeza 13 cent këto janë tarifa pa llogaritur TVSH-në.

Sa i përket numrit të konsumatorëve kemi 6256 dhe ata të ndanë në kategori të amvisrisë diku 5353 43 instucione dhe biznese janë 850,

Gjate periudhës 8 mujore janë faturu 484869 m³ me vlerë 332 mijë e 314 euro ndërsa janë inkasu 297693 norma e inkasimit 89.5%.

Valentina Leku, në si qytetar të komunës së Drenasit jemi të pakënaqur dhe të shqetësuar me menaxhimin e dobët nga kjo kompani, problemet me ujësjellësin janë kudo, Komorani IV është komplet infrastruktura e gatshme për intervenim rreth 100 m kanë mbet pa u intervenu, në fshatin Gjergjicë që 4 vite janë pusët e hapur, po ashtu shmicka e fshatrave mdaje edhe në qendër qytetaret janë duke u ballafaquar me probleme të ujit të pijes, të gjitha akuzat e qytetareve bien mbi komunën ndërsa investimet janë bërë dhe ju si përgjegjës t'i vazhdoni këto procedura, pse po i zvarritni, edhe sa qytetaret e Komunës së Drenasit pritet të furnizohen me ujë të pijes, kur do të përfundoj rrjeti i ujësjellësit?

Ismet Baliu, sa i përket Komoranit IV nuk është në pyetje për 100 m siç e potencove por nga viti 2015 komplet rrjeti i ujësjellësit ka qenë i përfunduar dhe është i përfunduar se bashku me kyqjet sekondare edhe qdo qytetar i Komoranit ka gypin dhe lidhjen deri në oborr, përgjegjësia e komunitetit ka qenë vetëm vendosja e ujëmarresve dhe pusëtave në oborr që këto obligim nuk e ka kry Komorani IV, rrjeti është aktualisht dhe mundet me qenë funksional shumë lehtë, unë me iniciativën dhe dy donatore që kemi pasur i kemi dërgu me i vendos orët matëse dhe me fillu furnizimin me ujë të pijes, komuniteti nuk ka shprehë gatishmëri për me bashkëpunua dhe me fillua furnizimin me ujë, sot kemi vetëm një valvule me e hap dhe me e furnizua me ujë Komoranin IV, është përgjegjësi e vetë komunitetit. Sa i përket fshatit Gjergjicë me të gjithë rrjetit e ujësjellësit të cilat janë të cilët janë të kyqur në rrjetin e qytetit, komuna apo ministria ka investua në nuk kemi informacion për burimin se sa është kapaciteti i burimit, a ka sasi të mjaftueshme të ujit, kualiteti i ujit, ai plotëson kushtet dhe standardet për furnizim me ujë nuk kemi një projekt të investimeve se çka është punu, komuna e ka drejtuar një kërkesë tek ne që me kalu në menaxhim edhe ajo pjesë mirëpo për shkak të mungesës të këtyre informacioneve drejtorja qendrore nuk ka marrë një vendim por ka kërkuar këto informacione.

Mehedin Salihu, pyeti: a janë të liruar personat me skeme sociale?

Ismet Baliu, kompania e ujësjellësit nuk ka asnjë vendim nga asnjë institucion që një kategori e caktuar lirohet nga pagesa e ujit.

Egzona Tërdevci, nëse e kuptova drejt kapaciteti i ujit ishte i mjaftueshëm për 60 mijë banor, mjafton të shtrihen rrjetat, nëse ndihmon komuna dhe ministria dmth qytetaret e Drenasit mund me u furnizua mjaftueshëm me ujë të pijes, po ashtu me beri përshtypje që e ceke që ka fshatra që është rrjeti i ujësjellësit por nuk menaxhohet nga KRU pse ka ndodh kështu? Cili është bashkëpunimi në mes KRU-së dhe Komunës kur behën investime në kanalizim në rrugë, sepse ndodh që dëmtohen gypat gjatë punimeve.

Ismet Baliu, fshatrat të cilët nuk janë në menaxhim te KRU nuk i menaxhojmë, fshatin Verboc, Krajkov, dhe Kishnarekë, ne nuk mund të funksionojmë pa bashkëpunimin me komunën.

Zeqir Hasi, aty ku ka pas defekt nuk janë kthi në gjendjen e mëparshme në Drenas, dhe një rast tjetër në rrugën “ Asllan Fazliu” që tri vite ka qenë një defekt dhe ka mbet rruga pa u kthi që gjendjen e mëparshme, qytetaret detyrohen me e mirëmbajt vet, si është e mundur që tri vite mos me rregullu këtë problem. Sa punëtor i keni për teren ju si kompani dhe sa i keni në administratë?

Ismet Baliu, intervenimet ku ka rrjedhje të ujit zakonisht nëpër rrugë të asfaltuara apo trotuare realisht çdo here ka një kontratë kornize me një kompani private për rregullimin e këtyre gropave, ne kemi pas kontakte me një kompani private me kontratë kornize tre vjeçare ku nuk i ka përfundua shërbimet ashtu siç duhet dhe është ndërpre kontrata me atë kompani, tani kemi lidhur kontratë të re me një kompani tjetër tani jemi në procesin e evidentimit të gjitha rasteve dhe besoj se ne afat sa më të shkurt do të rregullohen të gjitha. Sa i përket numrit të punëtorëve realisht i kemi 4 punëtor për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, e kemi një kryepunëtor, dhe i kemi 4 lexues për shpërndarjen e faturave, ndërsa në administratë i kemi 1 inspektor, 1 zyrtarë për konsumator dhe unë si menaxher.

Gani Krasniqi, a është me dëshirë se kush do me e vendos ujin apo është me ligj e përcaktuar?

Bekim Lestrani- u tha që kemi kapacitet për të gjithë ne kemi kapacitete për 60 mijë banorë që ne si komune në fakt nuk i kemi, deshta me dite që sa kohe kompania i ka këto kapacitete? U cekën disa fshatra që janë në fashën e finalizimit qka nënkupton kjo, sa është koha që i duhet kompanisë që me u finanizoj këto ,u ceken investimet e komunës me sa di unë edhe ne si kuvend çdo vite edhe vazhdimisht e kemi mbështet me investime me ujera te zeza është çudi si kompania është e thirrme për me i inkasu mjetet edhe për ujera te zeza por nuk ka strategji konkrete për sa kohe mundet me arrit me i shpërnda rrjetin në filan lokacionin, cilat janë investimet i ka bere kompania për ujera te zeza sa janë ato proporcion me donatorët për mendimin tim kjo është kompani duhet me qen më konkrete sa serioze me pas enje plan te qarte te zhvillimit te shërbimit .

Ismet Baliu-prej vitit 2015 ne e kemi këto kapacitete duke u bazuar ne këto kapacitet me çdo kemi filluar zgjerimin e rrjetave për fshatrat që janë në finalizim, rrjete kryesore me CDI janë bere për fshatin Verboc, Shtutice, Polluzhe, Tertenik 2 një pjesë Baice një pjesë Gllanaselle Godanc, Dobroshefc

Pjesën tjetër për Korreticë te Ulet dhe Korreticën e Lartë të gjitha këto rrjeta janë në finalizim diku 9 km gypa kryesor mirëpo pa kyçje sekondare pa kyçje familjare nuk janë bere kyqjet familjare akoma sepse donatori ka investu vetëm ne rrjetet kryesore, nuk do te thotë qe se kemi iniciativën çka me to në kemi parapa bashkëpunim edhe me Komunën se ka një tenderë për një numër te caktum ëe vendosjes se ujëmatësve për zonat rurale qe 3 mije ujëmatës edhe 3 mije kyçje familjare planifikohen me u bere ne bashkëpunim edhe me Komunën po edhe ujësjellësi, për 500 Komuna e ka një tender te shpallur vetëm duhet me përcaktua edhe zonën urgjente, të gjitha ato plane i kemi ato janë ne planin e investimeve

Valentina Leku-i nderuar me vjen keq qe nuk keni pas mundësi me ardhe ne dëgjime buxhetore po na kemi qenë aty edhe i kemi dëgjuar nga afër shqetësimet e qytetareve, kur pikërisht kryetarit i kanë thënë hajde ne shtëpinë time edhe shikoje nuk kam asnjë pike ujë ata nuk e dini si behet komplet ky projekt, pasi që 7 vite e keni këtë kapacitet edhe nuk janë kaq banore ne komunën e Drenasit sa merre kohe qe me u funizu këta qytetare që kanë nevojë për ujë qe nuk kane as ujë te pijshëm ,pavarësisht qe ka komuna tjera qe nuk janë aq mire me ujë te pijshëm ne nuk kemi nevojë mi marr si shembull ato qe janë keq neve na duhet me marr si shembull dikon qe është mire ose me vazhdu me be punën tone, faleminderit

Albulena Saliuku –e kame një pyetje a keni menduar a po e shihni te nevojshme qe te bëni rritjen e numrit te stafit për ujësjellës ne teren ne mënyrë qe te përfundojmë projektet ne kohe te planifikuar, Faleminderit.

Ismet Balia-sa i përket numrit te punëtorëve faktikisht agresioni për ujera i ka te percaktume kriteret per numër te konsumatorëve sa punëtor duhet me qene, në numrin e konsumatorëve e kemi dikun 6 mije e 265 konsumatorë, realisht është e vërtet qe kem nevojë ne te gjitha sektorët për rritje te stafit mirëpo kriteret na pengojnë pak,

Hamit Haxhiu-Faleminderit Kryesues se pari me vjen keq qatë pyetje e bëra unë dhe mu pergj me ato se ke pyetje pa lidhje nuk e besoj qe këtu bëjmë ndonjë pyetje pa lidhje, unë kërkoj qe me terheq ato me kerkur falje publikisht

Drejtoria e Shëndetësisë	115,000.00	8,750.00	13,650.00	156.00
Drejtoria e Arsimit	1,000.00	14,500.00	349.90	2.41
Gjithsej	144,900.00	165,933.30	224,134.94	65.38

Shpenzimet në projekte kapitale për periudhën janar–shtator 2022

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet deri me TM-3/2022	Mbetja	Progresi i TM-3/2022 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
16301 Admministrata e pergjithshme					
47913	Paisje tjera mbi 1000 euro	30,000.00	-	30,000.00	0.00%
	GJITHSEJ	30,000.00	-	30,000.00	0

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet deri me TM-3/2022	Mbetja	Progresi i TM-3/2022 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
18001	DSHPE				
47881	Bashkfinancim Projektesh	10,000.00	-	10,000.00	0.00
49291	Rregullimi dhe rrethimi I varrezav KK Drenas	40,000.00	33,463.71	6,536.29	83.66
47884	Renovimi dhe mirmbajtja e objektit të SHZSH Gllabar	5,736.48	4,245.00	1,491.48	74.00
49179	Zgjerimi dhe mirmbajtja e kamerav	5,000.00	-	5,000.00	0.00
49288	Rreg.dhe kultivimi I siperfaqev gjelbruese,mirmb	25,164.63	4,490.15	7,674.48	17.84
49290	Sinjalizimi Horizontal dhe vertikal I rrugve vendban.	22,500.00	14,988.00	7,512.00	66.61
49293	Instalimi I ndriqimit dhe riparimi I ekzistuesit	46,571.54	8,417.90	38,153.64	18.08
49294	Rregullimi dhe mirmbajtja e trotuarev dhe parkingjev	10,000.00	-	10,000.00	0.00
49296	Riparimi dhe zgjerimi I vendndaljev të autobusve dhe mbulimi I tyre	30,000.00	-	30,000.00	0.00
	GJITHSEJ	194,972.65	65,604.76	99,082.66	33.65

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet deri me TM-3/2022	Mbetja	Progresi i TM-3/2022 në %
	1	2	3	4=2-3	5=3/2
18161	Drejtoria e Infrastruktures Publike				
48254	Rregullimi I shtratit te lumit Drenica dhe Verbica	20,000.00	-	20,000.00	-
48613	Ndertimi I kolektorve per grumbullimin e ujrav te zeza	450,000.00	70,000.00	380,000.00	15.56
48617	Rregullimi I Infrastruktures trotuar, ndriqim publik Drenas	275,000.00	-	275,000.00	-
48626	Ndertimi I Infrastruktures Drenasi I,II,III,IV	198,470.72	49,007.75	149,462.97	24.69
48628	Infrastruktur Komorani I,II,III dhe IV	100,000.00	-	100,000.00	-
48632	Asfaltimi I rruges Gllanasell Godanc	50,000.00	-	50,000.00	-
48635	Asfaltimi I rruges fshati Paklek I Ri ,Vjeter dhe Vasilev	50,000.00	50,000.00	-	100.00
48636	Infrastruktur në fshatin Abri e eperme dhe Terdec	50,000.00	-	50,000.00	-
48638	Asfaltimi I rruges Dobroshec qikato v e vjeter	50,000.00	10,387.12	39,612.88	20.77
48641	Ndertimi I linfrastuktures ne fshatin Nekoc kishnarek	50,000.00	4,761.49	45,238.51	9.52
48643	Asfaltimi I rruges ne fshatrat Gradic dhe Likoshan	50,000.00	20,000.00	30,000.00	40.00
48646	Asfaltimi rruges Arllat Negroc Gjergjic Bytyq	50,000.00	-	50,000.00	-
48648	Asfaltimi I rruges Sankoc Fushticë	30,000.00	3,274.50	26,725.50	10.92
48650	Asfaltimi I rruges terdec vuqak	5,000.00	-	5,000.00	-
48653	Asfaltimi I rruges Shtutic,Verboc,Polluzhë	50,000.00	-	50,000.00	-
48656	Asfaltimi I rruges Llapushnik,Poterk Vukoc	50,000.00		50,000.00	-

48658	Asfaltimi I rruges Z. ulët, Lartë K. e ulët dhe e lartë	50,000.00		50,000.00	-
48661	Ndertimi I kapaciteteve të ujsjellsit Drenas	200,000.00	50,000.00	150,000.00	25.00
48682	Bashkfinancim projektesh me donator të jashtëm	50,000.00	-	50,000.00	-
48691	Hapja e kanaleve kulluese përgjatë rrugëve Drenas	10,000.00	-	10,000.00	-
48693	Kanalizimi I ujërave të zeza dhe atmosferike Drenasi 1,2,3,4	10,000.00	2,142.43	7,857.57	21.42
48694	Kanalizimi I ujërave të zeza Komorani I,II,III,IV	10,000.00	-	10,000.00	-
48705	Kanalizimi I ujërave të zeza Sankoc Fushticë e epër dhe ultë	10,000.00	9,208.50	791.50	92.09
48707	Kanalizimi I ujërave të zeza k.e ulët eperme dhe Paklek	10,000.00	9,408.50	591.50	94.09
48708	Kanalizimi I ujërave të zeza Dobroshec Qikatov e Vjeter	10,000.00	-	10,000.00	-
48709	Kanalizimi I ujërave të zeza Abri e eper Terdec	10,000.00	3,703.90	6,296.10	37.04
48710	Kanalizimi I ujërave të zeza Gllanasell Godanc	10,000.00	-	10,000.00	-
48711	Kanalizimi I ujërave të zeza Gradic Likoshan	10,000.00	-	10,000.00	-
48712	Kanalizimi I ujërave të zeza Llapushnik poterk vukovc	10,000.00	3,703.90	6,296.10	37.04
48713	Kanalizimi I ujërave të zeza Nekoc Kishnarek	10,000.00	7,674.50	2,325.50	76.75
49187	Ndertimi I Urave dhe Tombinave dhe mureve mbrojtse	180,000.00	103,445.21	76,554.79	57.47
49188	Rehabilitimi dhe rikonstruimi I rrugëve të asfaltuara Drenas	456,062.31	10,757.99	445,304.32	2.36
49189	Rehabilitimi dhe rikonstruimi I rrjetit të kanalizimeve në Dr.	200,000.00	105,341.93	94,658.07	52.67
49297	Zgjerimi dhe ndertimi I sheshit Fehmi e Gjev Lladroveci Dr.	220,000.00	-	220,000.00	-
49298	Kanal. I ujërave të zeza Krajkov baic Damanek Shtrubullov	10,000.00	7,760.60	2,239.40	77.61

51322	Kanalizimi u ujrave te zeza Tersteniku I,II dhe Gllobar	10,000.00	-	10,000.00	-
51323	Kanalizimi I ujrav te zeza shtutic verboc Polluzh	6,881.00	-	6,881.00	-
51324	Asfaltimi I rrugve Tersteniku I,II dhe Gllobar	60,000.00	-	60,000.00	-
51326	Kanalizimi I ujrave te zeza Arllat,NegrocGjergjie dhe Bytyq	10,000.00	-	10,000.00	-
51340	Asfaltimi I rruges Baic Krajkov Damanek Shtrubullo	50,000.00	-	50,000.00	-
48633	Asfaltimi I rrugës tersteniku I II	10,102.00	10,102.00	-	100.00
48640	Asfal.Rrug. Baic,Krajkov,Damanek	5,283.32	5,283.32	-	100.00
48703	Kanalizimi Arllat,Negroc,Gjergjicë	3,703.90	2,951.89	752.01	79.70
92136	Granti performances	504,917.47	310,612.67	194,304.80	61.52
	GJITHSEJ	3,665,420.72	849,528.20	2,815,892.52	23.18

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet deri me TM-3/2022	Mbetja	Progresi i TM-3/2022 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
47001	Bujqësia				
	Grant I donatorve te brendshem	2,213.25	-	2,213.25	-
	Gjithsejt	2,213.25	-	2,213.25	-

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet deri me TM-3/2022	Mbetja	Progresi i TM-3/2022 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
65005	Drejtoria e Gjeodezi Kadaster dhe Pronë - 65005				
47969	Shpronësimet	420,000.00	260,387.80	159,612.20	62.00
	GJITHSEJ	420,000.00	260,387.80	159,612.20	62.00

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet deri me TM-3/2022	Mbetja	Progresi i TM-3/2022 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
66310	Urbanizmi 66310				
49186	Gjelbrimi I hapsirav Publike	20,000.00	19,973.86	26.14	99.87
49184	Hartimi I Planev Rregulluese	15,000.00	-	15,000.00	-
	GJITHSEJ	35,000.00	19,973.86	15,026.14	57.07

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet deri me TM-3/2022	Mbetja	Progresi i TM-3/2022 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
73100	QKMF 73100				
49181	Paisje Speciale Mjeksore	322,856.00	247,785.00	75,071.00	76.75
	Gjithsej	322,856.00	247,785.00	75,071.00	76.75

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet deri me TM-3/2022	Mbetja	Progresi i TM-3/2022 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
85001	Drejtoria e Kulturës 85001				-
49182	Renovimi I Objektev Sportive	40,000.00	20,000.00	20,000.00	50.00
49183	Fushat Sportive dhe rekreacion	115,000.00	-	72,486.00	-
89114	Ndertimi I Stadiumit Faza e Dytë	100,000.00	-	100,000.00	-
50524	Inventarizimi I arhives dhe qendres kulturore	10,000.00	-	10,000.00	-

Kodi i projektit			Shpenzimet deri me TM- 3/2022		TM-3/2022 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
92005	Administrata Arsim 92005				
45082	Inventarizimi I Shkollav	40,000.00	-	40,000.00	-
51368	Renovimi I Shkoll.Nujev sanitare dhe suvatimi dhe ngjyrosja	127,000.00	1,867.81	125,132.19	2.28
49195	Furnizimi I shkollav me kabinete kimi,fizik,biologji	50,000.00	-	50,000.00	-
49197	Rip.i nxem.qendrore Gjergj kastroti dhe QEAP ARDH.	10,000.00	9,990.00	10.00	99.90
49194	Furnizimi I shkollav me paisje Tiku	70,000.00	42,330.00	27,670.00	60.47
51325	Dixhitalizimi I Institucionev Arsimore	80,000.00	-	80,000.00	-
49196	Renovimi I objektev shkollore	34,194.29			
	GJITHSEJ	411,194.29	54,187.81	322,812.19	13.18

611	GJITHSEJ KOMUNA	5,346,656.91	1,537,467.43	3,809,189.48	28.76
-----	------------------------	---------------------	---------------------	---------------------	--------------



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
Zyra e Kryetarit

01 Nr. 020/04-53415 dt. 18. 10 2022

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ (MAPL) NR. 02/2019 Për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane. Nenin 5 dhe 6 të udhëzimit administrativ për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur më _____ 2022 të aprovoi këtë:

PROPOZIM VENDIM .

Për formimin e komisionit për strukturën organizative dhe funksionale të fshatrave dhe lagjeve urbane më qëllim të organizimit dhe zgjedhjeve, funksionimit dhe mbikëqyrjes së udhëheqësisë së fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Drenasit

- I. Antaret e komisionit për strukturën organizative dhe funksionale të fshatrave dhe lagjeve urbane më qëllim të organizimit dhe zgjedhjeve, funksionimit dhe mbikëqyrjes së udhëheqësisë së fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Drenasit në këtë përbërje si vijon:
1. _____ nga ekzekutivi
 2. _____ nga shoqëria civile
 3. _____ antarë nga Kuvendi i Komunës
 4. _____ antarë nga Kuvendi i Komunës
 5. _____ antarë nga Kuvendi i Komunës
 6. _____ antarë nga Kuvendi i Komunës
 7. _____ përfaqësues nga fshati.
- II. Detyrat e komisionit janë organizimi i zgjedhjeve të organeve të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Drenasit në mbështetje të rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës në fshatra, vendbanime dhe lagjet urbane.
- III. Më këtë vendim do të njoftohen anëtarët e komisionit, Drejtoritë e Komunës dhe zyra e Kuvendit si dhe një mbetet në arkiv.
- IV. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.



Arsyetim

Duke pasur parasysh se mandati i komisionit të kaluar ka përfunduar, kërkohet nga Kuvendi i Komunës që të ri-emërojë komisionin e ri duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) NR. 02/2019 Për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr - 170/01 - 52435 dt. 12/10/2022

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 1, nenit 40, paragrafi 2 pika h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 3, pika 3.5 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më ____10.2022, të aprovojë këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shpalljen e Prof. Dr. Rexhep Meidani “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit

Neni 1

Me këtë Propozim Vendim, i propozohet Kuvendit të Komunës, shpallja e Prof. Dr. Rexhep Meidani “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.

Neni 2

Titulli “Qytetar Nderi” për Prof. Dr. Rexhep Meidanin, jepet për kontributin e tij për çështjen e Kosovës, në të gjitha nivelet, ato shkencore, politike dhe shoqërore, përgjatë dekadave.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Prof. Dr. Rexhep Meidani, u lind më 17 gusht 1944 në Tiranë. U diplomua në Universitetin e Tiranës në vitin 1966, Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN), dega Fizikë, si dhe përfundoi me sukses studimet pasuniversitare në Universitetin e Kanës, në Francë, në vitin 1974.

Në fushën profesionale z. Meidani punoi fillimisht si pedagog, si shef katedre dhe më pas si dekan i FSHN-së në vitet 1966- 1996. Gjatë kësaj periudhe, z. Meidani botoi një numër të madh studimesh, librash dhe artikujsh brenda e jashtë vendit. Ai mban titullin shkencor “Profesor, Doktor”.

Karriera politike e z. Meidani nisi pas viteve '90. Ai ishte Kryetar i KQZ-së në zgjedhjet e para shumë partiake më 1991 dhe anëtar i Këshillit Presidential në vitin 1991. Gjatë viteve 1992-1996 u angazhua në shoqërinë civile duke qenë edhe kryetar i bordit të Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut (1994-96). Më 1996 aderoi në Partinë Socialiste duke u zgjedhur Sekretar i Përgjithshëm i saj (1996-1997).

Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të qershorit 1997 z. Meidani u zgjodh deputet në Kuvendin e Shqipërisë. Pas zgjedhjeve, të cilat u fituan nga koalicioni i majtë i drejtuar nga Partia Socialiste, më 24 korrik 1997, me propozim të PS-së, Kuvendi i Shqipërisë e zgjodhi Prof. Dr. Rexhep Meidanin President të Republikës.

Prof. Dr. Rexhep Meidani ka dhënë kontributin e jashtëzakonshëm në arsimimin e gjeneratave të reja, promovimin e vlerave kombëtare dhe interesit nacional.

Roli i ish presidentit Meidani, gjatë luftës tonë çlirimtare, ishte i madh, duke qenë thellësisht i lidhur me vuajtjet e popullit shqiptar jashtë kufijve administrativ të Republikës së Shqipërisë.

Angazhimi i ish presidentit Meidani për çështjen e Kosovës, në të gjitha nivelet, ato shkencore, politike dhe shoqërore, përgjatë dekadave, është për t'u vlerësuar me titullin “Qytetar nderi” i komunës së Drenasit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr-170/01-52430 dt. 12/10/2022

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: Në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 1, nenit 40, paragrafi 2 pika h, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 3, pika 3.5 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më ____10.2022, të aprovojë këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shpalljen e Prof. Dr. Alfred Moisiu, “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit

Neni 1

Me këtë Propozim Vendim, i propozohet Kuvendit të Komunës shpallja e Prof. Dr. Alfred Moisiu “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.

Neni 2

Titulli “Qytetar Nderi” për Prof. Dr. Alfred Moisiu i jepet për kontributin e tij në politikën e mbrojtjes, të sigurisë rajonale si dhe për proceset historike që ka kaluar Kosova.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Prof. Dr. Alfred Moisiu i lindur më 1 dhjetor 1929, në qytetin e Shkodrës. Alfred Moisiu ka marrë pjesë në Luftën Antifashiste Nacional-Çlirimtare. Në vitet 1946-1948 kreu studimet në Shkollën e Inxhinierisë Ushtarake në Petersburg, Rusi, dhe u laureua në Akademinë e Inxhinierisë Ushtarake në Moskë me Medalje të Artë në vitet 1952-1958. Në vitet 1948-1949 ka qenë Komandant toge në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë; Instruktor në Akademinë Ushtarake “Skënderbej” në vitet 1949-1951; ka punuar në Drejtorinë e Xhenios të Ministrisë së Mbrojtjes në vitet 1958-1966.

Kursin e Lartë të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura e kreu në vitet 1967-1968 në Akademinë e Mbrojtjes në Tiranë.

Zoti Moisiu shërbeu si zëvendësministër i Mbrojtjes, nga viti 1981 deri në tetor 1982. Në vitet 1982-1984 ka qenë Komandant i Kompanisë së Xhenios në Burrel dhe në vitin 1985 doli në pension.

Në vitin 1991 zoti Moisiu u emërua Ministër i Mbrojtjes së Qeverisë Teknike, post të cilin e mbajti deri në vitin 1992. Në vitet 1992-1994 ai punoi si Këshilltar i Ministrit të Mbrojtjes; në vitet 1994-1997 ishte zëvendësministër për Politikën e Mbrojtjes.

Alfred Moisiu themeloi më 1994, Shoqatën Shqiptare të Atlantikut, ku u zgjodh President.

Në vitin 1995 kreu Kursin për Personalitete të Larta në Kolegjin Ushtarak të NATO-s, në Romë. Zoti Moisiu është autor i shumë shkrimeve, artikujve dhe studimeve të botuara në shtypin shqiptar e të huaj, për problemet e artit ushtarak, të politikës së mbrojtjes, të sigurisë rajonale si dhe për zhvillimet dhe proceset që janë zhvilluar në Kosovë. Alfred Moisiu mban titullin shkencor “Doktor i Shkencave Ushtarake”.

Prof. Dr. Alfred Moisiu, më 24 qershor të vitit 2002 zgjidhet President i Republikës së Shqipërisë.

Ish-Presidenti Alfred Moisiu, pas ndarjes nga jeta të bashkëshortes, ka trashëguar katër fëmijë, tri vajza dhe një djalë, i cili humbi jetën në një aksident tragjik, gjatë mandatit të tij si President.

Zoti Moisiu është njohës i tri gjuhëve, gjuhës ruse, italiane dhe angleze.

Andaj, angazhimi i ish presidentit Moisiu për çështjen e Kosovës, në të gjitha nivelet, ato shkencore, politike dhe shoqërore, përgjatë dekadave, është për t’u vlerësuar me titullin “Qytetar nderi” i komunës së Drenasit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01-Nr-170/01-52438 dt. 12/10/2022

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 1, nenit 40, paragrafi 2 pika h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 3, pika 3.5 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më ____10.2022, të aprovojë këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shpalljen e Prof. Dr. Bamir Topi “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit

Neni 1

Me këtë Propozim Vendim, i propozohet Kuvendit të Komunës, shpallja e Prof. Dr. Bamir Topit “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.

Neni 2

Titulli “Qytetar Nderi”, për Prof. Dr. Bamir Topi, jepet për kontributin e tij në promovimin e Republikës së Kosovës në skenën ndërkombëtare, duke mbështetur dhe përkrahur pa rezervë interesin nacional.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Prof. Dr. Bamir Topi, i lindur në Tiranë më 24 prill 1957, rrjedh nga një familje autoktone tiranase me tradita intelektuale e qytetare.

Pas përfundimit me rezultate të larta të studimeve në Universitetin Bujqësor të Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, Prof. Dr. Bamir Topi nisi punën në Petrelë, në Tiranë, ku spikati për përkushtimin dhe aftësitë e tij në fushën e Toksikologjisë dhe Farmakologjisë.

Në vitin 1984 emërohet bashkëpunëtor shkencor në Institutin e Kërkimeve Shkencore Veterinare, ku qëndroi deri në vitin 1995. Në vitet 1987-1990 kreu studimet pasuniversitare në Itali në fushën e Biologjisë molekulare, studime që i përfundon me marrjen e gradës Doktor i Shkencave. Pas kthimit nga Italia, u emërua Drejtor i Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe të Veterinarisë, pozicion që e mbajti deri në fund të vitit 1995.

Krahas punës si kërkues shkencor, Prof. Dr. Bamir Topi ka kryer edhe një aktivitet të ngjeshur akademik, në përgatitjen e programeve mësimore të Lëndës së Toksikologjisë dhe Farmakologjisë për studentët dhe pasuniversitarët e Fakultetit të Mjekësisë Veterinare; ka qenë gjithashtu lektor i këtyre lëndëve për një periudhë gati dhjetë vjeçare. Z. Bamir Topi merr titullin Profesor në vitin 1995. Krahas aktivitetit shkencor e pedagogjik, Bamir Topi ka edhe një aktivitet të gjerë politik, i cili daton që me fillimet e lëvizjes demokratike në vitin 1990. Në vitin 1996 u zgjodh për herë të parë deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe u emërua Ministër i Bujqësisë dhe Ushqimit deri në vitin 1997, kur Partia Demokratike kaloi në opozitë.

Prof. Dr. Bamir Topi është zgjedhur tri herë deputet i Kuvendit të Shqipërisë, dy herë Nënkyetar i Partisë Demokratike dhe Kryetar i Grupit të saj Parlamentar.

Prof. Dr. Bamir Topi, ish president, është ndër personalitetet e shquara të historisë së re të Republikës së Shqipërisë dhe kombit shqiptar, i lidhur ngushtë me fatin dhe çështjen e Kosovës.

Kontributi i tij, në krye të Republikës së Shqipërisë, i dha hov edhe promovimit të Republikës së Kosovës në skenën ndërkombëtare, duke mbështetur dhe përkrahur pa rezervë interesin nacional.

Angazhimi i tij në politikë dhe drejtimin e shtetit, përkrahjen e Kosovës dhe interesit të përgjithshëm nacional, është arsye për ta shpallur “Qytetar nderi” të komunës së Drenasit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr-170/01-52433 dt. 12/10/2022

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 1, nenit 40, paragrafi 2 pika h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 3, pika 3.5 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më ____10.2022, të aprovojë këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shpalljen e SH.T. Z. Prof. Dr. Bajram Begaj “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim, i propozohet Kuvendit të Komunës shpallja e SH.T.Z. Prof. Dr. Bajram Begaj “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.

Neni 2

Titulli “Qytetar Nderi” për SH.T.Z. Prof. Dr. Bajram Begaj, jepet për kontribut të shquar për Republikën e Kosovës dhe qytetarëve të saj, para luftës tonë çlirimtare dhe në veçanti gjatë luftës çlirimtare, si drejtues shëndetësor, për ushtarët e plagosur të UÇK-së.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

SH.T.Z. Prof. Dr. Bajram Begaj, është Presidenti i 8-të i Republikës së Shqipërisë, prej 24 korrikut 2022.

Ka lindur në qytetin e Rrogozhinës më 20 mars 1967.

Presidenti Begaj ka përfunduar studimet për mjekësi në Universitetin e Tiranës dhe i është bashkuar radhëve të Forcave të Armatosura Shqiptare, si mjek ushtarak në specializimin Gastro-Hepatologji.

Me një karrierë të gjatë ushtarake prej 32 vjetësh, ka mbajtur disa poste të rëndësishme dhe është vlerësuar me disa medalje për arritjet e tij.

Në vitin 2020, një muaj pas gradimit si Gjeneral Major, shërbeu si Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Ka përfunduar studimet doktorale dhe është autor i disa publikimeve shkencore. Prej vitit 2016, mban gradën shkencore Profesor i Asociuar.

Presidenti Bajram Begaj është i martuar me zonjën Armanda Begaj dhe kanë dy djem, Dorianin dhe Klajdin.

Sh. T. Z. Bajram Begaj, me përkushtimin e tij profesional e atdhetar, ka dhënë kontribut të shquar për Republikën e Kosovës dhe qytetarët e saj, para luftës tonë çlirimtare dhe në veçanti gjatë luftës çlirimtare, si drejtues shëndetësor, për ushtarët e plagosur të UÇK-së.

Presidenti Begaj, sot, në krye të shtetit, me agjendën e tij, mbron interesin e shqiptarëve kudo jetojnë, duke promovuar të drejtat dhe duke mbrojtur vlerat e shqiptarëve kudo jetojnë, si kontribuues të paqes dhe mirëkuptimit.

Kryetari i komunës së Drenasit, me krenari do të propozojë që ish presidentët dhe Sh. T. Z. Bajram Begaj, të shpallet “Qytetar nderi” i komunës së Drenasit, me qëllimin e përafrimit të vlerave, njohjes dhe promovimit të kontribuuesve institucional.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr 01-170/01-52550 dt. 13/10/2022

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 1, nenit 40, paragrafi 2 pika h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 3, pika 3.5 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më ____10.2022, të aprovoj; këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shpalljen e SH.T. Z. Edi Rama “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës shpallja e SH.T.Z. Edi Rama “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.

Neni 2

Titulli “Qytetar Nderi” SH.T.Z. Edi Rama, i jepet për mbrojtje të vlerave të luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si dhe përkrahjen e vazhdueshme për Kosovën, qytetarët e saj dhe të interesit të përgjithshëm nacional.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

SH.T.Z. Edi Rama është lindur në Tiranë, më 4 korrik 1964. Ai është i martuar me Linda Ramën dhe kanë tre fëmijë, Gregun, Rean dhe Zahon.

Edi Rama ka një karrierë të larmishme në arte, sport, mësimdhënie, publicistikë dhe politikë. Ka qenë pedagog i pikturës në Akademinë e Arteve, lojtar i ekipit kombëtar të basketbollit, autor i librave “Refleksione” në bashkëpunim me Ardian Klosin, botuar fill pas rënies së diktaturës, dhe “Kurban”, botuar në vitin 2011, i përkthyer në turqisht, serbisht e rumanisht. Po ashtu, Edi Rama ka botuar edhe dy libra arti me krijimet e tij në bashkëpunim me artistin e njohur Anri Sala, si dhe është autor e pjesëmarrës i shumë ekspozitave nëpër botë.

Përfshirja e Edi Ramës në jetën publike dhe politike zë fill me lëvizjen për demokraci që rrëzoi regjimin komunist në Shqipëri, ku ai ishte një nga zërat më të spikatur publikë, por edhe një drejtues i njohur i lëvizjes studentore në Akademinë e Arteve.

Pas një largimi disavjeçar jashtë Shqipërie, ku iu përkushtua jetës artistike, por kritik aktiv në shtyp i qeverisjes së parë post-komuniste, Edi Rama hyri në politikë si Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në vitin 1998. Gjatë periudhës që drejtoi këtë ministri, ai fitoi mbështetjen dhe vlerësimin e publikut shqiptar për mënyrën kreative dhe të efektshme të promovimit të artit dhe kulturës në vend.

Në vitin 2000, Edi Rama kandidoi për Bashkinë e Tiranës me mbështetjen e Partisë Socialiste, duke shënuar një fitore të thellë ndaj rivalit të tij. Pas fitores, ai ndërmori një fushatë transformimi dhe rigjenerimi të kryeqytetit, duke rikthyer hapësirat publike të pastruara nga ndërtimet pa leje, duke shtuar hapësirat e gjelbra dhe përgjithësisht duke sjellë një vizion dhe frymë të re administrimi të punëve të kryeqytetit.

Nën lidërsipin e Edi Ramës, Bashkia e Tiranës u kthye në një institucion modern evropian. Projektet e tij për futjen e ngjyrës në hapësirën publike përmes fasadave të rrënuara të banesave popullore të periudhës komuniste, rehabilitimi i shtratit të Lumit Lana, shtimi i parqeve dhe hapësirave të gjelbra në kryeqytet dhe rindërtimi me standarde të reja projektimi i rrjetit rrugor të Tiranës janë vlerësuar me një sërë çmimesh ndërkombëtare, ku mund të përmenden, World Mayor Award (2004) dhe European Hero Award i revistës Time. Edi Rama u rizgjodh sërish Kryetar i Bashkisë Tiranë në vitin 2003 dhe 2007 dhe për 11 vjet drejtoi kryeqytetin e Shqipërisë.

Në vitin 2005, Edi Rama u zgjodh Kryetar i Partisë Socialiste të Shqipërisë, të cilën e udhëhoqi gjatë viteve të vështira në opozitë dhe në fitoren plebishitare të 23 qershorit 2013. Nën drejtimin e Ramës si Kryeministër, Shqipëria fitoi statusin e vendit kandidat në vitin 2014.

Nën këtë leadership nisi zbatimi i një reforme epokale në sistemin e drejtësisë, reformë që do të pastrojë nga sistemi të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët që nuk mund të shpjegojnë burimin e pasurisë së tyre apo që kanë dhënë vendime arbitrare në të shkuarën. Gjithashtu, në periudhën 2013-17, u zbatuan një numër reformash të tjera thelbësore, si reforma në sektorin e energjisë elektrike, ajo e skemës së pensioneve, reforma administrativo-territoriale, reforma në administratën publike, etj.

Një prej treguesve më pozitivë, gjatë mandatit të parë të qeverisë “Rama” ishte nxjerrja nga puna në të zezë e punësimi real i më shumë se 200 mijë shqiptarëve dhe përshejtimi i rritjes ekonomike, nga niveli thuajse zero i gjetur në 2013-n, në mbi 3,5%. Institucionet ndërkombëtare vlerësojnë se rritja ekonomike do të kalojë barrierën e 5%, deri në 2020-n.

Në zgjedhjet e 25 qershorit 2017, Edi Rama udhëhoqi socialistët drejt një mandati të dytë qeverisës. Pas rezultatit të thellë të shënuar në zgjedhje, për herë të parë në 25 vjet, një forcë politike do të drejtojë e vetme vendin, pa pasur nevojën e formimit të një koalicioni qeverisës.

Kam nderin e veçantë që të propozojë para Asamblesë komunale të Drenasit për miratim, propozimin për shpalljen “Qytetar Nderi”, të SH.T.Z. Edi Rama.

Kryeministri Edi Rama, është ndër personalitetet më të shquara të politikës shqiptare, i cili sfidave të aktualitetit i përgjigjet me kompetencë dhe qasje të re nga paraardhësit e tij, duke prezantuar një profil të ri të mundësive të politikës shqiptare në vend dhe në botë.

Kontributi i tij, në krye të Qeverisë së Shqipërisë, është hov i ri në zhvillimin ekonomik e infrastrukturor të Shqipërisë dhe rajonit, në veçanti të marrëdhënieve me Kosovën, të cilën e prezanton në dritën më të mirë, synimet dhe qëllimet e saj në forumet ku zëri i Kosovës nuk mund të jetë i pranishëm.

Angazhimi i tij në politikë dhe drejtimin e shtetit si Kryeministër dhe lider i një partie, është dëshmi e fortë për angazhim shumë cilësor të politikës shqiptare në Evropë dhe në NATO, në OKB dhe institucionet globale demokratike.

Përkrahja e vazhdueshme për Kosovën, për mbrojtje të vlerave të luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si dhe përkrahjen e vazhdueshme për Kosovën, qytetarët e saj dhe të interesit të përgjithshëm nacional, është arsye për ta shpallur “Qytetar nderi” të komunës së Drenasit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr. 01-170/01-52628 dt. 13/10/2022

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 1, nenit 40, paragrafi 2 pika h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 3, pika 3.5 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më ____10.2022, të aprovoj; këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shpalljen e znj. Ana Roch “Qytetare Nderi” e Komunës së Drenasit

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës shpallja e Znj. Ana Roch “Qytetare Nderi” e Komunës së Drenasit.

Neni 2

Titulli “Qytetare Nderi” znj. Ana Roch, i jepet për kontributin e dhënë në “Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Gruas në Drenas” dhe promovimin e kësaj qendre në Kantonin e Zvicrës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës
Ramiz Uldrovci

ARSYETIM

Ana Roch ka lindur në vitin 1973 në Gjenevë 1. Prindërit e saj janë të dy me origjinë nga Galicia në Spanjë. Ajo u rrit në Les Avanchets me vëllain e saj në një familje ku punonin të dy prindërit. Ana Roch përfundon trajnimin e saj si një punonjëse tregtare, më pas bëhet një mësuese praktike. Ajo mori një diplomë federale si specialiste në menaxhimin e SME-ve dhe një certifikatë të kompetencës në të drejtën zvicerane. Në vitin 2015, ajo mori drejtimin e biznesit familjar në sektorin e ndërtimit. Ana Roch e filloi politikën duke u përfshirë në nivel lokal dhe asociativ në komunën e Vernier. Në veçanti, ajo është këshilltare komunale për këtë qytet dhe drejton një klub futbollit në distriktin Avanchets 3, 2. Ajo ishte presidente e Maison de jeunes de l'Éclipse për 15 vjet. Ajo është një aktiviste në Lëvizjen Qytetare të Gjenevës (MCG). Nga viti 2015, ajo forcoi angazhimin e saj politik duke iu bashkuar zyrës së trajnimit politik 3 . Në vitin 2016, ajo njoftoi synimin e saj për të kandiduar për presidencën e MCG 4 . Ajo fitoi zgjedhjet, me një votë përpara liderit të lëvizjes historike Eric Stauffer 5, 6.

Në tetor 2018, ajo është kandidate në zgjedhjet shtesë për këshillin administrativ të qytetit Vernier, duke zëvendësuar Thierry Apothéloz, i zgjedhur në Këshillin e Shtetit.

Znj. Ana Roch dha kontributin e saj për Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave në Drenas duke ju ofruar përkrahje dhe promovim në kantonin e Gjenevës në Zvicër, duke ju siguruar një kontratë për shitjen e varësve të punuara nga gratë e po kësaj qendre "QPDG-së".